

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE PËR SHMANGIE NGA
KONFLIKTI I INTERESIT

RREGULLORE PËR SHMANGIE NGA KONFLIKTI I INTERESIT

Referencat:

1. WKF Conflict of Interest Regulation
2. Ligji Nr. 9367 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike
3. Investopedia
4. Statuti i FKK-së

I. Fushëveprimi

Kjo rregullore është e aplikueshme për FKK-n ose palët e përfshira, anëtarë të FKK-së, kur ndodh një konflikt interesit. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme për të gjitha palët, personat juridikë, të gjithë anëtarët ose stafin me përgjegjësi aktuale të vendimmarrjes brenda çështjeve të shqyrtuara.

II. Përkufizimi

Neni 1

1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, profesionale, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.
2. Konflikti interesit mund të ekzistojë kur gjykimet apo veprimet personale mund të ndikohen nga një interes privat ose personal, që çon në përfitim personal, financier ose profesional. Siguria e pjesëmarrësit mund të ndikohet nga një prirje nga ana e hulumtuesit për të pasur një rezultat të favorshëm.

Neni 2

1. Konflikti i interesit ndodh kur një entitet/subjekt ose individ bëhet jo i besueshëm për shkak të një përplasjeje midis interesave personale dhe detyrave ose përgjegjësive profesionale.
2. Besimi në FKK vihet në rrezik kur sjellja e një anëtarë të personelit të FKK-së përfshihet ose duket sikur përfshihet në një konflikt mes interesave personale dhe detyrimeve ndaj FKK-së.
3. Anëtarët e personelit të FKK-së duhet të shmangin sjelljet që çojnë anëtarët e publikut të gjerë të konkludojnë se ai/ajo po përdor postin e tij për interesa vetjake profesionale apo interesa të ndonjë të afërmë të tij. Në raste të tillë konfliktesh apo të përceptuara si të tillë nevojitet largimi dhe mënjanimi nga çështja apo situata.
4. Konflikt i interesit është konflikti ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të drejtpërdrejta ose të tërthorta të një Zyrتari të Federatës, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose kanë për qëllim të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij në FKK.

III. Llojet e konfliktit të interest

Neni 3

1. Në vlerësimin e situatave, interesat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta duhet të merren parasysh. Këtu përfshihen interesat e një personi të tretë (p.sh., prindi, partneri, lidhja familjare ose vartësi/t), pozitat e dyfishta brenda FKK-s.
 2. Në renditjen e mëposhtme, por jo vetëm të shembujve, rrethanat në të cilat mund të lindë një konflikt interesit janë:
 - 2.1 Kur interesat personale të një Zyrtari ndërhyjnë me interesat e FKK-së;
 - 2.2 Kur një Zyrtar apo një i afërm i tij përfiton në mënyrë të padrejtë apo të tërthortë të mira materiale apo financiare për shkak të pozicionit të Zyrtarit në FKK.
 - 2.3 Kur një Zyrtar, pa pasur lejen paraprake të Bordit Ekzekutivë të FKK-së, ka marrëdhënie pune apo është anëtar i organeve drejtuese për një federatë tjeter.
 - 2.4 Kur Zyrtari përdor apo ndan me të tjerët informacion konfidencial të FKK-së për përfitime personale apo për përfitime të të afërmve të tij.
 - 2.5 Kur Zyrtari pranon përfitime personale (p.sh. më shumë se sa një dhuratë modeste) nga një person apo organizatë që ka lidhje apo pret të bashkëpunojë me FKK-në në çfarëdo lloj transaksi biznesi;
 - 2.6 Kur Zyrtari merr vendime për favorizim të personave në këmbim të mbështetjes së tyre në zgjedhjet e përgjithshme apo organet drejtuese të FKK-së.
 3. Pozita funksionale me llogaridhënie dhe përgjegjësi të dyfishtë në FKK.
- 4. Interesat financiare:**
- 4.1 Përfshijnë mundësitë kur një individ përdor gjykimin/pozitën e tij profesional për përfitim financiar personal ose në përfitim të një kompanie/grupi/klubi në të cilën individi ka interes financiar ose angazhim tjeter.
- 5. Interesa jofinanciare:**
- 5.1 **Personale:** Kur interesat e tjera të një individ mund të ndikojnë te rezultatet e caktuara, stafi apo pjesëmarrësit, apo klubit/grupit të caktuar, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij në organizatë,
 - 5.2 **Professionale:** Kur një individ ka mundësinë për rritje profesionale, bazuar në përfshirjen e tij detyrë të caktuar, si personale ashtu edhe të grupit/klubit/stafit; kur një anëtarë i Bordit të FKK-së gjendet në një pozitë tjeter funksionale e cila përfshinë përgjegjësi dhe llogaridhënie ndaj vet Bordit dhe FKK-së,
 - 5.3 **Institucionale:** Kur përfitimet dhe/ose interesat financiare/personale dhe profesionale mund të ndikojnë apo duket se ndikojnë te puna ose aktivitetete të tjera të FKK-së,
 - 5.4 **Të përceptuara:** Kur shfaqja e konfliktit është e njojur tek të tjerët dhe mund të vërë në pikëpyetje përshtatshmërinë e përfshirjes së atij personi në detyrë.

IV. Detyrim

Neni 4

Konflikti i interest është i ndaluar. Çdo zyrtar i FKK-së, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij në FKK, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdekclarim paraprak. Secili person në një situatë ku ekziston një konflikt i mundshëm i interesave duhet të zbulojë/tregojë për situatën me konflikt të interstit, ashtu siç përcaktohet në Nenin 5 më poshtë.

V. Zgjidhja e konflikteve dhe shmangia

Neni 5

1. Është përgjegjësi personale e secilit person të shhangë situatat ku ekziston një konflikt interesë. Në një situatë të tillë, personi në fjalë duhet ta deklarojë situatën menjëherë tek Bordi/Kryetari/Sekretari i FKK-së.
2. Informacioni i dhënë do të mbahet konfidencial.
3. Komisioni për Çështje Juridike është përgjegjëse për këshillimin e individëve në një situatë të mundshme të konfliktit të interesit.

VI. Procedura

Neni 6

1. Çdo rast i konfliktit të interesit trajtohet në përputhje me dispozitat e Statutit të FKK-së dhe kësaj Rregulloreje.
2. Bordi Ekzekutiv i FKK-së është përgjegjës, në shkallën e fundit, për marrjen e vendimeve në lidhje me konfliktin e interesit.

VII. Veprimet

Neni 7

1. Në rastë të gjetjes në situatë të konfliktit të mundshëm interesë, personi/zyrtari në fjalë duhet në të gjitha rastet të përbahet nga dhënia e gjykimit të tij, përfshirja, angazhimi, nga marrja e një vendimi ose nga pranimi i çfarëdo forme përfitimi.
2. Në rast dyshimi, personi duhet të kërkojë këshillën e Kryetarit të FKK-së.
3. Kryetari/Bordi Ekzekutiv/ Sekretari do t'i propozojë personit në fjalë kushtet e veprimit dhe mënyrën e daljes nga situate, duke i ofruar alternativat e mëposhtme:
 - a) Regjistrimi i deklaratës pa ndonjë masë të veçantë;
 - b) Largimin e personit të përfshirë nga pjesa/pozita/detyra ose anulimin e gjithë veprimit ose heqjen e vendimit tëi palës në themel të konfliktit;
 - c) Heqja dorë nga menaxhimi i interesit të jashtëm që shkakton konfliktin.

Neni 8

1. Masa plotësuese, shtesë këtyre tri opsiioneve, gjithashtu mund të propozohen. Pastaj, personi në fjalë do të ndërmarrë hapat që i konsideron të përshtatshëm.


Neni 9.

- Pas miratimit të Bordit Drejtues të FKK-së dhe nënshkrimit të kryetarit, secili akt në këtë rregullore duhet të zbatohet nga ana e komisionit përkatës të FKK-së.

Neni 10.

- Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullorje pushon të vlejë Rregullorja e deritashme.

Në Prishtinë me



Kryetari i FKK-së
Ismet Krasniqi